



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA GRAMSH
KËSHILLI BASHKIAK

PROCES-VERBAL

Mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak Muaji MARS mbajtur sot me datë 28/03/2024 ora 10:00 mbajtur në sallën e re të Keshillit , te Nënprefektura.

Në mbledhje marrin pjesë 14 këshilltarë: Enis Zani, Albert Ceci, Ardiana Hasa, Kodhel Cala, Visarion Bici, Kujtim Brahimi, Arnilda Dakare, Fatbardh Cekrezi, Ramazan Braho, Erisa Zogu, Ardiana Hasa, Erald Carciu, Marsela Ibro, Dalip Hazizaj, Brunilda Gjevori.

Mbledhja drejtohet nga Kryetari i Këshillit z. **Enis Zani**.

Në zbatim të Nenit 192 të rregullores së Këshillit Bashkiak; "Kryetari i Bashkisë ka të drejtë të ftojë stafin e tij në mbledhjet e Këshillit , për të dhënë shpjegime juridike dhe ligjore për projekt vendimet e paraqitura nga ekzekutivi në mbledhjen e Këshillit "; asistuan në mbledhje disa prej drejtorëve dhe përgjegjesit e drejtorive përkatëse që dorëzuan projekt vendimet dhe relacionet.

E.Zani: Pershendetje, duke qene se kurumi eshte plotesuar mbledhjen e deklaroj te hapur, kemi 6 pika ne rend dite, kemi edhe 2 material shtese:

- 1- Per dhenien e ndihmes financiare te shtetasit Dallim Selman Mema per shkak te renies se zjarrit me date 26.02.2024, fshati Irmath NJA Kukur, Bashkia Gramsh.
- 2- Mbi domosdoshmerine e vendosjes se tarifave te sherbimit te kanalizimeve te ujrave te ndotura per njesine e Ujesjelles Kanalizime Gramsh.

Jeni dakort per ti futur keto ne rend dite?

***Miratohet futja e dy materialeve shtese ne rendin e dites me 14 Vota PRO**

E.Zani: Votojme rendin e dites?

***Miratohet rendi i dites me 14 Vota PRO**

Sekretari Këshillit
Xhulia Gjini

Kryetari i Këshillit
Enis Zani



Çështja 1

1- Për dhënien e ndihmës ekonomike për muajin SHKURT 2024 (fondi 6%).

Në mbledhje marrin pjesë 14 këshilltarë:Enis Zani, Albert Ceci, Ardiana Hasa,Kodhel Cala, Visarion Bici,Kujtim Brahimi,Arnilda Dakare, Fatbardh Cekrezi, Ramazan Braho,Erisa Zogu,Ardiana Hasa, Erald Carciu,Marsela Ibro,Dalip Hazizaj,Brunilda Gjevori.

Pergj.Ndh.Ek.:Pershendetje, per Shkurt 2024 jane gjeneruar 35 familje per perfitim ekonomik ne total, ju ftoj te votoni materialin nese skeni pyetje.

E.Zani : Votojme?

***Miratohet pika e 1 e rendit të ditës me 14 Vota PRO**

Sekretari Këshillit
Xhulia Gjini

Kryetar i Këshillit
Enis Zani



Çështja 2

2- Për hartimin e planit të punës,për parandalimin dhe masat që do merren për mbrojtjen e fondit pyjor/kullosor publik nga zjarret.

Në mbledhje marrin pjesë 14 këshilltarë:Enis Zani, Albert Ceci, Ardiana Hasa,Kodhel Cala, Visarion Bici,Kujtim Brahimi,Arnilda Dakare, Fatbardh Cekrezi, Ramazan Braho,Erisa Zogu,Ardiana Hasa, Erald Carciu,Marsela Ibro,Dalip Hazizaj,Brunilda Gjevori.

Inxh.Dr.Pyjore: Pershendetje, kemi hartuar planin e punes per parandalim/shuarjen e zjarreve per vitin 2024.Masat qe do te merren per te parandaluar situatat qe shkaktojne zjarrvenien.

F.Cekrezi : Keni te dhena nga 2023 ?

Inxh.Dr.Pyjore: Per 2023 kemi vetem nje rast zjarri ne ekonomine pyjore Vidhan-Skenderbegas,, e cila u kap ne kohe.Plani ka qene shume eficient. Kemi 5 vrojtues per rastin e zjarreve, jane te shperndare neper NJA, per periudhen Maj-Tetor.

E.Zani : E hedhim ne votim ?

***Miratohet pika e 2 e rendit të ditës me 14 Vota PRO**

Sekretari Këshillit
Xhulia Gjini



Çështja 3

3- Për një shtesë në linjën e transportit rrethqytetës Holtas-Gramsh dhe anasjelltas.

Në mbledhje marrin pjesë 14 këshilltarë: Enis Zani, Albert Ceci, Ardiana Hasa, Kodhel Cala, Visarion Bici, Kujtim Brahimi, Arnilda Dakare, Fatbardh Cekrezi, Ramazan Braho, Erisa Zogu, Ardiana Hasa, Erald Carciu, Marsela Ibro, Dalip Hazizaj, Brunilda Gjevori.

Dr. Taksave: Per shkak te kerkesave te banoreve te fshatit Holtas, kerkohet nje shtese linje pasi bejne nje rruge prej 5 km ne kembe. Kemi aktualisht 2 operatore te licensuar. Do behet me konkurs te hapur, jane disa kriteret per tu plotesuar.

K. Brahimi : Ne cdo fshat operon nga nje makine ne dijenine time, pse nuk i detyroni ata te licensohen ?

Dr. Taksave: Kemi 28 linja te licensuara ne gjithë territorin e bashkise Gramsh. U kemi derguar policise se rendit dhe asaj bashkiake listat me ata qe jane te licensuar per te evidentuar ata qe jane ne shkelje te ligjit per te marre masat e duhura.

V. Bici : Dua qe te zbatohet kjo license vetem per ate linje qe ka bere kerkesen, jo per fshatra te tjere

F. Cekrezi : Operoret aktuale i demton kjo shtese, linje e 3-te ? Lista me nenshkrime te qytetareve duhet te kete bashkengjitur ID e secilit person. Operoret duhet te ishin prezent ne mbledhje.

E. Zani : Votojme ?

***Miratohet pika e 3 e rendit të ditës me 14 Vota PRO**

Sekretari Këshillit
Xhulia Gjini



Çështja 4

4- Mbi përfundimin e procesit të zgjedhjes së Kryesisë dhe Kryetarit të Fshatit Grabovë e Sipërme të Njësisë Administrative Kukur të Bashkisë Gramsh dhe afatin e nisjes për shpërblimin e tyre.


Në mbledhje marrin pjesë 14 këshilltarë: Enis Zani, Albert Ceci, Ardiana Hasa, Kodhel Cala, Visarion Bici, Kujtim Brahimi, Arnilda Dakare, Fatbardh Cekrezi, Ramazan Braho, Erisa Zogu, Ardiana Hasa, Erald Carciu, Marsela Ibro, Dalip Hazizaj, Brunilda Gjevori.

Sek. Këshillit: Sa i përket zgjedhjes së Kryetarit në fshatin Grabovë e Sipërme, është kryer procedura sipas ligjit me konsensus të banorëve të fshatit dhe mbas njoftimit nga Administratori. U ngrit grupi i këshilltarëve dhe shkuan në fshat, zhvilluan mbledhjen dhe mbas ngritjes së kryesisë u zgjodh Kryetar Fshati z. Nisi Paco.

E. Zani : Jeni të qartë, Votojme ?

***Miratohet pika e 4 e rendit të ditës me 14 Vota PRO**

Sekretari Këshillit
Xhulia Gjini



Arnilda Dakare

Erald Carciu

Çështja 5

5- Raport mbi veprimtarinë e Këshillit Bashkiak për vitin 2023 dhe transparencën në procesin e vendimmarrjes.

Në mbledhje marrin pjesë 14 këshilltarë: Enis Zani, Albert Ceci, Ardiana Hasa, Kodhel Cala, Visarion Bici, Kujtim Brahimi, Arnilda Dakare, Fatbardh Cekrezi, Ramazan Braho, Erisa Zogu, Ardiana Hasa, Erald Carciu, Marsela Ibro, Dalip Hazizaj, Brunilda Gjevori.

Sek. Këshillit: Raporti ka të bëjë me gjithë veprimtarinë e këshillit sa i përket vitit 2023. Janë marrë 96 vendime në total.

Sek. këshillit relacionon raportin lidhur me llojet e vendimeve të marra, lidhur me degjësat publike të zhvilluara.

Janë bërë disa trajnime të këshilltarëve nga Bashkita e Forta.

Ka patur përherë bashkëpunim të mirë midis Këshillit dhe administratës së bashkisë.

**Sekretari Këshillit
Xhulia Gjini**

**Kryetar i Këshillit
Enis Zani**

Çështja 6
(materiali shtese qe u fut ne rend te dites)

6- Per dhenien e ndihmes financiare te shtetasit Dallim Selman Mema per shkak te renies se zjarrit me date 26.02.2024, fshati Irmath NJA Kukur, Bashkia Gramsh.

Në mbledhje marrin pjesë 14 këshilltarë:Enis Zani, Albert Ceci, Ardiana Hasa,Kodhel Cala, Visarion Bici,Kujtim Brahimi,Arnilda Dakare, Fatbardh Cekrezi, Ramazan Braho,Erisa Zogu,Ardiana Hasa, Erald Carciu,Marsela Ibro,Dalip Hazizaj,Brunilda Gjevori.

Pergj.Sek.Emergj.Civile: Sic jeni njohur me materialin, ne banesen e shtetasit D. Mema nga nje shkendije elektrike u shkaktua zjarr. (vazhdon relatimin e materialit).

Ne i propozojme keshillit te aprovoje 50% te shumes qe ka dale nga preventivi.

K.Cala : Mua me duken te pamjaftueshme kaq leke.

Pergj.Sek.Emergj.Civile: Bashkia deri ne 50% mund te jape. Ne preventiv beme vetem per nje dhome qe ishte demtuar.

A.Hasa : A e keni planifikuar transportin ?

E.Zani : Do shihet nga bashkia se cfare mund te behet me mjetet e veta.

E.Zani : Votojme ?

***Miratohet pika e 6 e rendit të ditës me 14 Vota PRO**

Sekretari Këshillit
Xhulia Gjini

Kryetar i Këshillit
Enis Zani

Çështja 7

(materiali shtese qe u fut ne rend te dites)

7- Mbi domosdoshmerine e vendosjes se tarifave te sherbimit te kanalizimeve te ujrave te ndotura per njesine e Ujesjelles Kanalizime Gramsh.

Në mbledhje marrin pjesë 14 këshilltarë: Enis Zani, Luljeta Dollani, Greta Lena, Albert Ceci, Ardiana Hasa, Kodhel Cala, Visarion Bici, Kujtim Brahimi, Arnilda Dakare, Brunilda Ballolli, Fatbardh Cekrezi, Idri Kokla, Ramazan Braho, Brunilda Gjevori.

F.Cekrezi : Per procedure sipas rregullores, neni 156/4 cdo ceshtje qe ka te beje me ndryshime taksash, kerkon patjeter prezencen ne mbledhje te Kryetarit te Bashkise, eshte pertej tagrit tone institucional.

(Vjen ne mbledhje Nen Kryetari z.T.Bici).

Perfaqesuesi i Dr.Ujesjelles Kanalizime Elbasan : Arsyeja e sjelljes se ketij relacioni eshte se bashkia ka sjelle nje akt te ne ku gjithë afatet e parashikuara kishin kaluar. Nga muaji qe vjen do te behet e gjithë puna nga ana jone, kerkojme nga ju bashkepunim ne baze te vendimeve, duhet te vihen tarifa, te cilat do te sherbejne per te dhene pagat e puntoreve qe do te vine ne Elbasan (kalim ne dokumentacion , pra do jene nen Dr.Ujesjelles Kanalizime Elbasan,dhe fizikisht punojne po ketu ne Gramsh).

Kemi propozuar tarifat e tre vendeve, tarifen e zgjidhni ju sa do e vendosni, nuk e bemni dot sherbimin pa vendosur tarifen. Do te tarifohen vetem fshatrat qe kane kanalizim te ujrave te zeza.

Nenkryetari : Ka nje vendim Keshilli qe ujrave te zeza te kalojne prane Dr.Ujesjelles Kanalizime Elbasan , eshte bere vetem kalimi, deri tani e ka subvencionuar bashkia. Bashkia i ka paguar punonjesit vet, tani qe do i kalojne shoqerise aksionere dhe smund ti kryeje sherbimet me vetfinancim. Para se enti rregullator i ujit te vendose nje tarife qe te permbush perballimin e rrogave dhe sherbimeve, duhet vendosur nje tarife nga ne.

F.Cekrezi : Relacioni nuk permbush kushtet formale,le te mblidhet komisioni dhe te shohim me tej. Propozoj te shtyhet.

E.Zani : Jeni dakort te shtyjme materialin per ta shqyrtuar nje moment tjeter ?

***Vendoset shtyrja e ketij materiali ne nje tjeter mbledhje.**

**Sekretari Këshillit
Xhulja Gjini**

**Kryetar i Këshillit
Enis Zani**

Çështja 8

8-Kerkesa te Qytetareve, te Tjera.

Në mbledhje marrin pjesë 14 këshilltarë: Enis Zani, Luljeta Dollani, Greta Lena, Albert Ceci, Ardiana Hasa, Kodhel Cala, Visarion Bici, Kujtim Brahimi, Arnilda Dakare, Brunilda Ballolli, Fatbardh Cekrezi, Idri Kokla, Ramazan Braho, Brunilda Gjevori.

Diskutohet për kerkesën e qytetarit M. Balla e cila ndodhet në gjendje të rënduar shëndetsore dhe i duhet të kryejë një operacion në zëmër, për shkak të gjendjes së rënduar shëndetsore si dhe pamundësisë ekonomike i drejtohet Këshillit për të dhënë mbështetje financiare.

E.Zani: Jeni dakort të japim një shumë simbolike për të ardhur sadopak në ndihmë zonjes? Votojmë për miratim kerkesën e saj?

***Miratohet kerkesa e znj. Myrvete Balla me 14 Vota PRO**

Sekretari Këshillit
Xhulia Gjini

Kryetar i Këshillit
Enis Zani

Adresa: Sheshi "Kamber Dermishi" Bulevardi "10 Korriku" Tel/Fax: 0513 2 2272 E-mail: bashkiagramsh@gmail.com



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA GRAMSH
KESHILLI BASHKIAK

Gramsh, më 28/03/2024

LISTË PREZENCË E KËSHILLTARËVE BASHKIAK

Mbledhja e Rradhës e Këshillit Bashkiak Muaji MARS 2024

| EMER MBIEMER | 28 MARS 2024 | EMER MBIEMER | FIRMA |
|-----------------------|--------------|------------------|-------|
| 1- KODHEL ÇALA | 28.03.2024 | Kodhel Çala | |
| 2- VALBONA VERUSHI | | | |
| 3- LULJETA DOLLANI | | | |
| 4- ENIS ZANI | 28.03.2024 | Enis Zani | |
| 5- GRETA LENA | | | |
| 6- VISARION BICI | 28.03.2024 | Visarion Bici | |
| 7- ARDIANA HASA | 28.03.2024 | Ardiana Hasa | |
| 8- ALBERT CECI | 28.03.2024 | ALBERT CECI | |
| 9- RAMAZAN BRAHO | 28.03.2024 | Ramazan Braho | |
| 10- EDMOND GURI | | | |
| 11- ERALED ÇARÇIU | 28.03.2024 | Erald Çarçiu | |
| 12- IDRI KOKLA | | | |
| 13- ERISA ZOGU | 28.03.2024 | Erisa Zogu | |
| 14- KUJTIM BRAHIMI | 28.03.2024 | Kujtim Brahimi | |
| 15- MARSELA IBRO | 28.03.2024 | Marsele Ibro | |
| 16- ALFRIDA SHAHINI | | | |
| 17- DALIP HAZIZAJ | 28.03.2024 | Dalip Hazizaj | |
| 18- ARNILDA DAKARE | 28.03.2024 | Arnilda Dakare | |
| 19- BRUNILDA BALLOLLI | | | |
| 20- FATBARDH ÇEKREZI | 28.03.2024 | Fatbardh Çekrezi | |
| 21- BRUNILDA GJEVORI | 28.03.2024 | Brunilda Gjevori | |

SEKRETARI I KËSHILLIT
XHULIA GJINI